



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-28277/24 datë: 23.10.2024



Npi – 01/343 datë: 31.10.2024

Duke u bazuar në nenin 12.2 shkronja (d) si dhe nenin 17 shkronja (k dhe l) të Ligjit Nr.03/L-040 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008); Nenin 25 i Ligjit Nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit; Statutin e Komunës së Shtimes Nr.01-06/1636 të datës 03.09.2008; Kuvendi i Komunës shqyrtoi propozimin e Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi Nr.02/1106 të datës: 24.10.2024 për ndryshimin e vendimit Npi-01/313 të datës 27.09.2024, sipas rekomandimit të Ministrisë të Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), Nr.6498-2/24 dt.17.10.2024, si dhe Rekomandimin e KPF-së, Npi – 01/335 të datës:29.10.2024, Kuvendi në seancën e mbajtur më 31.10.2024 miratoi këtë:

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN E BAZËS LIGJORE TË VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES, Npi-01/313 TË DATËS 27.09.2024

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në Seancën e -X- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më: 31.10.2024, me shumicën e votave miratoi vendimin për plotësimin e bazës ligjore të vendimit të Kuvendit me numër Npi-01/313 të datës 27.09.2024, si vijon: “Nenin 25 i Ligjit Nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit”, sipas rekomandimit të MMPHI-së, Nr.6498-2/24 dt. 17.10.2024.

II

A r s y e t i m: Në Vendimin e mëparshëm të Kuvendit me numër Npi-01/313 të miratuar më 29.09.2024, baza ligjore ka qenë si vijon:

“Duke u bazuar në nenin 12.2 shkronja (d) si dhe nenin 17 shkronja (k dhe l) të Ligjit Nr.03/L-040 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008); Statutin e Komunës së Shtimes Nr.01-06/1636 të datës 03.09.2008”

Pas Rekomandimit të MMPHI-së, Nr.6498-2/24 dt.17.10.2024, për Rishqyrtimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/313 të datës 27.09.2024, “Për ndarjen e 11052 m² sipërfaqe për ndërtimin e objekteve për projektin e banimit të Përballeshëm dhe Social”, Kuvendi i Komunës së Shtimes mori vendim sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb - faqen e Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi